

**Akti i Themelimit
i Shoqërie me Përgjegjësi të Kufizuar
“ALP Construction”**

Themeluesit me poshte:

- Lusiana Hoxha, shtetas shqiptar me banim ne Tiranew ne rr. Haxhi Xhediku. Mbajtes i kartes se identiteti nr K25516035R. Ne vijim do te quhet “Ortak”

Sot me date 2/8/2022, bazuar ne vullnetin e tyre te lire dhe ne perputhje me ligjin nr 9901, date 14/04/2008 “Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare”, vendosen te themelojne shoqerine tregtare me pergjegjesi te kufizuar:

“ALP Construction” sh.p.k.

ne baze te kushteve qe vijojne:

Kreu I

Objekti, emertimi, selia, regjimi juridik

Neni 1. Objekti i shoqerise

1.1 Shoqeria ka kete objekt veprimtarie:

Punime ndertimi, punime hekuri.

1.2 Shoqeria kryen cdo lloj veprimtarie te dobishme per arritjen e objektivave te saj.

Neni 2. Emertimi dhe Selia juridike e Shoqerise

2.1 Ortaket vendosen qe shoqerine ta emertojne

“ALP Construction” sh.p.k.

2.2 Selia juridike e shoqerise ndodhet ne Ambjent me siperfaqe 8 m2, Njesia Bashkiake nr.8, Rr. Haxhi Xhediku Nd.25 H.1 Zona Kadastrale 8340; Numer Pasurie 4/728 - ND 1017.

2.3 Shoqeria mund te krijojë qendra sekondare, filiale, zyra perfaqesimi e agjensi ne qytete te tjera te Shqiperise ose jashte vendit.

Neni 3 Regjimi Juridik

3.1 Shoqeria eshte, shoqeri me pergjegjesi te kufizuar. Veprimtaria e saj i nenshtrohet dispozitave te Aktit te Themelimit, Statutit dhe legjislacionit ne fuqi ne Shqiperi.

3.2 Me vendim te tyre Ortaket mund te ndryshojne regjimin juridik te Shoqerise n.q.s ne te ardhmen krijohen premisa me te favorshme per funksionimin e saj sipas legjislacionit shqiptar. Ne kete rast Ortaket do te pershtasin Aktin e Themelimit dhe Statutin e shoqerise dhe do te bejne regjistrimin e saj ne Regjistrin Tregtar ne organet kompetenete shqiptare.

3.3 Shoqeria gezon personalitet juridik nga data e regjistrimit te saj ne Qendren Kombetare te Biznesit dhe ne perputhje me ligjin.

3.4 Shoqeria do te kete vulen e saj.

Kreu II

Te Drejtat dhe Detyrat, Kohczgjatja

Neni 4. Te drejtat e Shoqerise dhe te Ortakut

4.1 Shoqeria ka te drejte te lidhe mareveshje dhe te nenshkruaj kontrata ne territorin e Shqiperise dhe jashte saj.

4.2 Shoqeria gezon te drejten te krijojë pasuri materiale dhe intelektuale.

4.3 Shoqeria ka te drejte te mare pjese si ortak ne shoqeri ose ndermarje te ndryshme ne Shqiperi ose jashte saj ne perputhje me legjislacionin Shqiptar.

4.4 Shoqeria pergjigjet ndaj te treteve vetem dhe ekskluzivisht me kapitalin e saj



shoqeror te derdhur dhe me te mirat e pasurise se saj.

4.5 Ortaket kane te drejte te marin te gjitha informatat qe kane te bejne me veprimtarine prodhuese, projektuese, realizuese tregtare te Shoqerise, si bilancet, llogarite ekonomike etj.

4.6 Ortaket kane te drejte te bejne propozime, si dhe emerone e shkarkojne administratorin ose administratoret, punonjesit, ekspertin kontabel apo likujdatoret.

Neni 5 Kohezgjatja

5.1 Kohezgjatja e Shoqerise eshte me afat te pacaktuar

Kreu III

Kapitali themeltar, kuotat

Neni 6

6.1 Kapitali themeltar eshte 100 leke dhe eshte i ndare ne 1 kuote.

6.2 Ndarja e pjeseve ne kapitalin themeltar eshte:

- Lusiana Hoxha, zoterues i nje kuote te shoqerise me vlere 100 leke me qe perben 100 % te kapitalit te shoqerise.

Kreu IV

Organet e Shoqerise

Neni 7

7.1 Vendimet e Shoqerise merren nga Ortaket ne Asamblene e Pergjithshme. Keto vendime shenohen ne Librin e Shoqerise. Administratori shoqerise dhe eventualisht eksperti kontabel i autorizuar caktohen nga Ortaket e shoqerise.

Kreu V

Administrimi

Neni 8

8.1 Administrimi i shoqerise do te behet nga 1(nje) administrator Ortaket emeruan administator te shoqerise znj. Lusiana Hoxha.

8.2 Kohezgjatja ne detyre e administratorit te shoqerise do te jete 5 (pese) vjet me te drejte ripertitje ne perfundim te mandatit.

Kreu VI

Dispozita te tjera

Neni 9

9.1 Fitimi i realizuar nga shoqeria mbas shlyerjes se detyrimeve ligjore do te mbetet ortakeve te shoqerise ne raport me zoterimin e kuotave te kapitalit.

9.2 Ky Akt shtypet dhe firmoset ne kater kopje, te gjitha me te njejten vlere ligjore. Nje kopje qendron ne dokumentacionin baze te shoqerise.

ORTAKUIVETEMI

SHOQËRISE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

"ALP Construction" SH.P.K.

Lusiana Hoxha

Lusiana Hoxha